



Prishtinë, 24.06.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1538_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2290_03_22** i dt.14.03.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **07.04.2022**;

në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.B (F.S) nga komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2290_03_22, i datës 14.03.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 14.03.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2290_03_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit dhe ka obliguar KESCO-n që konsumatorin me shifër **DPR – 90101670** ta shkarkojë nga borxhi i energjisë elektrike deri në periudhën 31.08.2017(**4,830.49€**) i cili borxh është krijuar si rezultat i mos pagesave të energjisë elektrike. Po ashtu KESCO obligohet që për borxhin e krijuar në shifrën **DPR – 90101670** ta kërkojë përmes procedurës gjyqësore, nga personat që e kanë krijuar dhe që pika matëse që evidentohet në emër të A.B tani e tutje duhet të regjistrohet në emër të konsumatorit F.S, pasi që është pronar i ligjshëm i kësaj patundshmërie.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Gjendja e shpenzimit dhe faturimit të energjisë elektrike në shifrën DPR 90101760 ka qenë e verifikuar, faturimi është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsor dhe me shpenzimin e bërë.
- Shifra DPR90101670 ka qenë duke shfrytëzuar energjinë elektrike si konsumator i paregjistruar deri në shkurt të vitit 2015, kur i njëjti ngarkohet me shpenzimet e regjistruara në njehsor në vlerë prej 4,301.87 euro.
- Konsumatori A.B gjatë periudhës 2015-2019 ka qenë në kategorinë “Raste Sociale” dhe sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme për Energji Elektrike neni 24 – “Mbrojtja për konsumatorët e energjisë elektrike në nevojë”, trajton rastet e “konsumatorëve në nevojë”



dhe atë neni 24, paragrafi 1: *“Konsumatorët familjar të cilët e kanë pranuar vendimin mbi statusin e tyre të konsumatorit në nevojë sociale, kanë të drejtë në mbrojtje të vecantë në përputhje me nenin 49, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Energji Elektrike”.*

- Në këtë aspekt konsumatori paraprak ka qenë shfytëzues i energjisë elektrike si kategori sociale dhe e njejta është mbrojtur nga e drejta e furnizuesit për të kërkuar shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik si rezultat i borxheve të krijuara.
- Pala F.S ka aplikuar për ndërrim emri duke dëshmuar përmes kontratës për shitblerjen e patundshmërisë ndërmjet tij dhe pronarit të tokës Faik Tahiri. Njehsori elektrik i cili është pronësi e Operatorit të Shpërndarjes nuk përcakton dhe nuk ndërlidhet me pronësinë e tokës, e për më tepër me rastin e ndërrimit të pronarit, çështja e borxheve ka qenë e rregulluar sipas marrëveshjeve kontraktuale mes tyre.
- Sipas Kontratës së shitblerjes Nr.LRP-së 8952/2017 nr.REF 1670/2017 datë 04.09.2017, shitësi ngarkohet që të paguaj ose evitoj të gjitha borxhet eventuale ose ngarkesat e tjera eventuale. Një gjë të tillë mund ta bëj edhe blerësi nën kostot e shitësit, me kushtin që i njejti e ka njoftuar dhe ftuar me shkrim shitësin për koston përkatëse dhe afatin e pagesës së kostos në fjalë. Në këtë kuptim çdo mosmarrëveshje mes tyre për borxhin e ngarkuar sipas kontratës së shitblerjes, bazuar në nenin 13 të kontratës së shitblerjes, Gjykata kompetente në Kosovë ka juridiksion të plotë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve eventuale në lidhje me përmbajtjen e detyrimeve të palëve sipas kësaj kontrate.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2290_03_22 i datës 14.03.2022 për konsumatorin A.B (F.S).

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i i ZrRE-së, pas pranimit të kundërshtimit nga KESCO, ka analizuar të gjitha shkresat, provat dhe dokumentet veç e veç, më saktësisht: Ankesën e konsumatorit në KESCO datë 21.08.2020; Ankesën e konsumatorit të datës 05.05.2021; Transaksionet e konsumatorit; Kontratën e shitblerjes së patundshmërisë LRP: nr.8952/2017, Refer. Nr. 1670/2017 e datës 04.09.2017; Rrjedhën e energjisë elektrike dhe ka gjetur se Vendimi i marrë nga DMK është vendim i ligjshëm dhe i bazuar në ligjet dhe rregullat në fuqi.

Në vështrimin e rastit nga fillimi, Bordi ka vërejtur se, me datë 21.08.2020 konsumatori F.S ka bërë kërkesë në KESCO që të bëhet shlyerja e borxhit në vlerë **4,830.49€** në shifrën **DPR – 90101670** si dhe të bëhet ndërrimi i emrit bazuar në kontratën për shitblerjen e patundshmërisë si dhe që borxhi i papaguar është në emër të A.B kurse prona është blerë nga Faik Tahiri. Me datë 23.04.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij në arsyetimin se bazuar në procedurën e brendshme për ndërrimin e emrit në shifrën ekzistuese paraprakisht duhet të bëhet pagesa e borxhit si dhe dokumentet e tjera me të cilat vërtetohet pronësia e pronës përfshi edhe kontratën mbi shitblerjen e pronës. Më tutje, si shenjë pakënaqësie parashtuesi i ankesës F.S ka apeluar përgjigjen e KESCO – Departamentit për Konsumator në DMK të ZRRE-së. Konsumatori ka theksuar se ai nuk e ka krijuar atë shpenzim të energjisë elektrike dhe se atë e ka krijuar A.B. Konsumatori gjithashtu ka theksuar se ai posedon kontratën e shitblerjes së pronës, e cila kontratë tregon qartë se kur ka qenë pronar legjitim i patundshmërisë.



Bordi i ZrrE-së e ka analizuar në përpikmëri këtë kontratë për shitblerjen e patundshmërisë në mes të Faik Tahiri - shitësi, dhe F.S -blerësi të datës 04.09.2017, me të cilën objekt i shitjes është paluejtshmëria me numër të njësisë kadastrale nr.P-71914059-04451-0 me sipërfaqe të përgjithshme 44m² dhe lloji i shfrytëzimit aktual është tokë ndërtimore- shtëpi-ndërtesë me oborr, vendi i quajtur "Kajtaç Ramadani" Zona Kadastrale Prishtinë. Në nenin 7, pika 4 të kontratës theksohet se: *"Të gjitha detyrimet e tanishme, tatimet dhe të gjitha ngarkesat komunale që e ngarkojnë paluejshmërinë kontraktuese deri në ditën e dorëzimit në pronësi dhe posedim të lirë tek blerësi i bartë shitësi"*. Kjo kontratë është noterizuar te Noteri me datë 04.09.2017. Si rrjedhojë e kësaj analize Bordi konstaton se parashtruesi i ankesës F.S është pronar legjitim i patundshmërisë nga data 04.09.2017, siç vërtetohet përmes kontratës së shitblerjes dhe sa i përket obligimit të bërë nga KESCO drejtuar konsumatorit për pagesën e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej **4,830.49€**, KESCO ka rënë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi, pasi që këtë borxh KESCO është dashtë ta inkasoi nga personat të cilët e kanë bërë shpenzimin e energjisë elektrike, përkatësisht nga A.B, e jo nga personat të cilët nuk e kanë krijuar.

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet: *"konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja"*. Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet: *"furnizuesi duhet të faturtojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve"*, andaj në këtë rast në atë periudhë KEK e më vonë edhe KEDS nuk kanë vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk kanë arrit të inkasojnë borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull". Edhe në rast të pamundësisë së inkasimit të rregullt të këtij borxhi KEK dhe KESCO ka mund ta kërkojë borxhin edhe përmes procedurës gjyqësore.

Mbështetur në këto dispozita Bordi i ZRrE-së konstaton se KESCO duhet që konsumatorin me shifër **DPR – 90101670** ta shkarkojë nga borxhi i energjisë elektrike deri në periudhën kohore 31.08.2017, i cili borxh është krijuar si rezultat i mos pagesave të energjisë elektrike nga personat tjerë para blerësit, si dhe borxhin e krijuar në këtë shifër deri në periudhën 31.08.2017 KESCO duhet ta kërkojë përmes procedurës gjyqësore nga personat që e kanë krijuar. Gjithashtu Bordi konstaton se KESCO duhet të bëjë edhe ndërrimin e emrit të shifrës **DPR – 90101670** nga A.B në pronarin e ri F.S.

Bordi i ka analizuar me kujdes edhe transaksionet e konsumatorit dhe Rrjedhën e energjisë elektrike të shifrës **DPR – 90101670** e cila evidentohet në emër të konsumatorit A.B dhe ka vërejtur se kjo pikë matëse është duke u faturuar nga periudha 02/2015 e tutje. Nga analiza e bërë transaksioneve të konsumatorit shihet se borxhi i energjisë elektrike deri në periudhën e muajit 31.08.2017 ka qenë **4,830.49€**. Bordi duke u bazuar edhe në kontratën e shitblerjes së patundshmërisë konstaton se parashtruesi i ankesës F.S është pronar legjitim i patundshmërisë nga data 04.09.2017, siç vërtetohet përmes kontratës së shitblerjes dhe sa i përket obligimit të bërë nga KESCO drejtuar konsumatorit për pagesën e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej **4,830.49€**, KESCO ka rënë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi, pasi që këtë borxh KESCO është dashtë ta inkasoi nga personat të cilët e kanë bërë shpenzimin e energjisë elektrike.



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në kundërshtimin e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit A.B (F.S) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.